



Mirë se vini në Kosovë

Kosova, shteti më i ri Evropës, është në pritje për t'u rizbuluar. Është e lehtë - thesari i vogël fshihet pas masivit të Bjeshkëve të Nemura, 2 orë në lindje të Adriatikut. Historia e Kosovës është dramatike dhe e jashtëzakonshme. Një tokë e lakmuar për perandoritë më të fuqishme të kohës. Aty ndahet dhe bashkohet orienti dhe oksidenti, me gjithë tiparet e tyre religjioze dhe identitare, kurse etnitë, gjuhët, zakonet janë po aq të llojlojshme. Gjurmët janë aty: qytete të fortifikuara romake, manastiret mesjetare, xhamitë osmane, kullat dhe shumë monumente tjera. Kosova në një mënyrë, është pasqyrë e historisë së Ballkanit. Pse ishte aq tokë e lakmuar?, përgjigje e thjeshtë: - tokat pjellore, pasuri nëntokësore, lumenjtë, klimë të përshtatshme dhe bjeshkë.

Sot, perspektiva e turizmit është thesar. Kosova ofron mundësi të jashtëzakonshme për të zhvilluar turizmin kulturor, malor, rural dhe shëndetësor. Është esenciale që shteti të orientohet në turizëm si prioritet nacional, duke punuar shumë në përmirësim të imazhit, ndërtim të infrastrukturës dhe forcim të sektorit privat. <Thesar i vogël, por i bukur për t'u rizbuluar>.

Sali Shoshi
Trashëgimia kulturore pa kufij

Fshati Gumnishtë (Foto: Shukrane Begu)

Përmbajtja

Parathënie

Faqe 7

Arritja në Vushtri

Faqe 9

Ngjarjet kulturore

Faqe 12

Ushqimi dhe pijet e veçanta në Vushtri

Faqe 14

Çfarë të shihni

Faqe 18

Udhëtime ditore

Faqe 26

Tregu

Faqe 29

Redaktimi

Menaxhim:
Zana Hoxha - CHwB

Koordinatorët e projektit:
Avni Mehmeti
Egzona Azemi
Shabal Latifi
Shukrane Begu


Hulumtimi:
Bledian Salihu

Dizajni dhe faqosja:
Ylber Cërvadiku

Përkthimi:
Kaltrina Thaçi

Muzeu Historik Etnografik - Vushtri
shërbeu si burim për fotografi dhe historik.

Fakte të shpejta për Kosovën



Pavarësia:
17 February 2008

Popullimi:
1 804 944

Sipërfaqja:
10 908 km²

Origjina etnike:
Shqiptarë 88%,
Serbë 7%,
të tjerë 5%
(boshnjakë, goranë, romë, turq, ashkali, egjiptian).

Gjuhët zyrtare:
Shqip, serbisht

Religjioni:
Muslimanë (88%),
Ortodoksë serbë (7%),
besime tjera (5%).

Festat zyrtare

17

Viti i Ri

E premte, 1 Janar
E shtunë, 2 Janar

Krishtlindjet Ortodokse

E enjte, 7 Janar

Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës

E mërkurë, 17 Shkurt

Dita e Pashkëve Katolike

E diele, 27 Mars

Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës

E shtunë, 9 Prill

Dita e Pashkëve Ortodokse

E diele, 1 Maj

Dita Ndërkombëtare e Punës

E diele, 1 Maj

Dita e Evropës

E hënë, 9 Maj

Fitër Bajrami, dita e parë

Kurban Bajrami, dita e parë

Krishtlindjet Katolike


E diele, 25 Dhjetor

* kur një festë është të dielën, atëherë të hënën e ardhshme është pushim.



© Ky udhërrëfyes është pronë e Zyrës turistike.
Qendra ka të drejtë për të riprodhuar udhëzuesin kur
ka fonde në dispozicion.

Vizitoni Zyrën Turistike brenda të kalasë së vjetër të
qytetit
Rruga: Hoxhë Kadri Prishtina



Mirë se vini në Vushtri

Gjatë qëndrimit tuaj në Vushtri do të mahniteni me tri fenomene. Do të vizitoni një urë të braktisur nga lumi i saj, një kala të braktisur nga ushtarët e saj dhe një hamam pa ujë. Gjatë qëndrimit tuaj kënaquni me atraksionet lokale dhe kaloni kohë me banorët lokal.

Fahri Buçinca
qytetar

ARRITJA NË VUSHTRRI

Me aeroplan

Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari"(ANP, www.airportpristina.com) është 15 km në perëndim të qendrës së qytetit të Prishtinës. Aeroporti gjendet në një ndërtesë të re me shërbime të ndryshme, duke filluar nga kafenetë, dyqanet e liruar nga taksat, bankomatët dhe shërbimet tjera. Udhëtimi me taksì për në qendër të Prishtinës do të kushtojë rreth 15 € dhe merr rreth 20 minuta. Taksì drejtpërdrejtë për në Vushtri do të kushtojë diku 30 € deri 40 €, por ne preferojmë të udhëtojmë me autobus nga stacioni i autobusëve në Prishtinë, ku ka autobusë të rregullt për në Vushtri.

Me autobus

Ekzistojnë dy linja direkte të autobusëve për në Vushtri, njëra nga Prishtina dhe tjetra nga Mitrovica. Linja Prishtinë - Mitrovicë mund të përdoret për të arritur në Vushtri, meqenëse ajo ndalet në kilometrin e 22-të, të rrugës para së të arrijë në Mitrovicë. Bileta kushton rreth 1.00 euro (0.70 euro për studentë) dhe mund të merret në autobus. Udhëtimi për në Vushtri zgjat rreth 35 minuta, ndërsa nisja bëhet nga stacioni qendror i Prishtinës, çdo 15 minuta nga ora 06:00 deri në 20:30. Linjë tjetër është ajo nga Mitrovica për në Prishtinë, me kohëzgjatje të udhëtimit rreth 15 minuta dhe çmim të biletës, 0.50 euro. Gjithashtu ekziston edhe linja nga Peja për në Mitrovicë, që niset çdo 3 orë, katër herë në ditë, duke filluar nga ora 07:00 deri më 16:00.

Me automobil

Të gjitha rrugët të shpien në qendër të qytetit dhe ngasësit që i afrohen Vushtrisë nga Prishtina apo Mitrovica, shumë lehtë mund të gjejnë qendrën e qytetit, nëse i përcjellin shenjat. Në pjesë të ndryshme të qytetit ka parking me roje, i cili kushton 0.50 euro, kurse në qendër 1.00 euro.





Valuta monetare dhe çmimet

Në Kosovë përdoret euro (€). Bankënotat në euro vijnë në vlera prej €5, €10, €20, €50, €100, €200 dhe €500. Monedhat, dizajni i të cilave varion, varësisht nga shteti në të cilin janë stampuar, vijnë në vlera prej €0.01, €0.02, €0.05, €0.10, €0.20, €0.50, €1 dhe €2. Ne iu këshillojmë të merrni para kesh, pasi që vende pranojnë kartela të kreditit apo debitit. Sidoqoftë, ju mund të tërhiqni para në bankomatët, të cilët gjenden kudo. Jeta në Kosovë, konsiderohet si e lirë nga të huajt.

Popullimi

Komuna e Vushtrrisë ka 67 vendbanime. Numri total i banorëve në komunë është rreth 70.000. Vushtrria ka mjaft të rinj, nivel të lartë të natalitetit dhe ka migrim lokal, regional dhe të jashtëm.

Feja

Shumica e shqiptarëve kosovarë dhe disa komunitete tjera janë zyrtarisht muslimanë sunitë, me një përqindje të vogël të respektimit të rendeve suni dhe një numër të vogël të katolikëve. Relacioni në mes të besimeve është shumë i mirë. Popullata serbe në Kosovë është kryesisht ortodokse. Kosova, sikurse Shqipëria, nuk konsiderohen fetare sa Turqia apo Lindja e Mesme, ndërkas pirja e alkoolit dhe duhanit nuk janë tabu për shumicën, dhe gratë e mbuluara shumë rrallë mund të shihen, veçanërisht në vendet urbane.

WC-të

Qyteti nuk ka WC publike. Më së miri është të shkoni në ndonjë hotel, kafene apo restorant dhe të kërkonti përdorimin e WC-së.

Vizat & formalitetet e hyrjes

Qytetarët e EU-së, SHBA-ve dhe Kanadasë mund të qëndrojnë në Kosovë për 90 ditë pa pasur nevojë për ndonjë dokument. Nëse planifikoni të shkoni në Serbi pas qëndrimit tuaj në Kosovë, sigurohuni që udhëtimin tuaj ta bëni përmes ndonjë shteti tjetër, meqenëse Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet. Në anën tjetër, nuk ka asnjë problem nëse udhëtoni nga Serbia për në Kosovë. Mund të kontrolloni faqen: <http://www.mfa-ks.net/?page=2,87> dhe të shihni nëse keni nevojë për vizë.



Gjuha

Në Kosovë, gjuhë zyrtare janë dy: gjuha shqipe dhe serbe. Gjuha angleze fliet nga shumica e vendorëve, ndërsa gjuha turke fliet deri diku.

Elektriciteti

Rryma elektrike në Kosovë është 220v AC. Mos u shokoni nëse përjetoni ndalje të rrymës në Kosovë, sepse kjo mund të ndodh, ndërkas shumica e hoteleve dhe restoranteve kanë sistem mbështetës.



Komunikimi

Në Kosovë ekzistojnë tri kompani të mëdha telefonike. Ju mund të blini një sim-kartelë për 3 euro, me të cilën ju vjen edhe një pako interneti. Sidoqoftë, ju mund të përdorni romingun apo Wi-fi. Interneti Wi-fi është mjaft i shpërndarë, kështu që juve ju mbetet të kërkonti fjalëkalimin në kafene apo restorante.



Klima

Klima në Kosovë është kryesisht kontinentale, që rezulton me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë, me ndikim mediteran dhe alpine (temperatura mesatare në shtet varion nga +30 °C (në verë) deri në -10 °C (në dimër).

Shëndeti

Rrini të shëndetshëm gjatë qëndrimit tuaj në Vushtri. Pini lëngje dhe vishuni varësisht nga moti. Rekomandohet që të keni sigurim shëndetësor. Ju mund të trajtoheni në spitale publike, por ekzistojnë edhe ato private (uji është i pijshëm në Vushtri).



Historiku

Antikiteti: Lugina e Vushtrrisë vendoset nga Ilirët, tribe e Dardanëve. Në kohën e Perandorisë Romake, ajo njihet si Vicianum dhe ka qenë gjithmonë një qytet komercial me prodhime të ndryshme.

Shekulli i 13-të: Vushtrria së bashku me Kosovën bëhen qendra administrative dhe kulturore të qytetit mesjetar serb.

Shekulli i 15-të: Në dokumentet otomane, qyteti njihet si Vushtrri dhe është themeluar si vend i Sanxhakut të Vushtrrisë. Sanxhaku ka qenë një nga territoret më të rëndësishme Evropiane për shkak të koncentrimit të madh të xeheve. Ka shërbyer si qendër e madhe militare dhe komerciale deri në rënien e Perandorisë Otomane.

Shekulli i 15-të - 18-të: Gjatë kësaj kohe, Vushtrria ishte qyteti më i rëndësishëm në Kosovë. Udhëtari i njohur Evliya Çelebi, i cili vizitoi Kosovën në 1661, e përmend Vuçitërnën (Vushtrrinë) si qendër të Sanxhakut. Ai e përshkruan Vucitërnën, të njohur si një qytet i njerëzve

të pasur me shumë bujtina dhe dhoma për pritje të shokëve dhe mysafirëve.

Shekulli i 19-të: Prej vitit 1877 deri më 1913, Vushtrria ishte pjesë e Vilajetit të Kosovës dhe Mbretërisë Osmane.

Shekulli i 20-të: Në Korrik të vitit 1912 kryengritësit e lirisë së Kosovës, çliruan Vushtrrinë nga Mbretëria Otomane. Pas Luftës së Parë Ballkanike të vitit 1912, Konferenca e Ambasadorëve në Londër mundësoi krijimin e shtetit të Shqipërisë, duke lënë anash Kosovën, edhe pse shumica e popullatës së Kosovës mbetën shqiptarë. Në të njëjtin vit, pushtuesit serbë erdhën dhe okupuan qytetin, i cili mbeti i tillë deri më 1999.

2008: Më 17 Shkurt, Parlamenti i Kosovës deklaroi Pavarësinë. Në qershor, Kushtetuta e Re e Kosovës hyri në fuqi, duke i dhënë grupeve të minoriteteve të drejta të veçanta.

NGJARJET KULTURORE

Vushtrria është qendër ekonomike, edukative, kulturore dhe sportive. Komuna ka investuar mjaft në përmirësimin e kualitetit të jetës për qytetarët dhe si rezultat, ka shumë aktivitete dhe festa në qytet, të organizuara nga komuna dhe në vendet rrethuese, sikurse “Takimet e Poeteshave Shqiptare”, etj.

VENDTAKIMET:



Qendra e Kulturës “Hasan Prishtina”

Rruga “Dëshmorët e Kombit” pa numër, afër sheshit “Hasan Prishtina” dhe objektit të komunës.

Ndërtesa e vjetër e qendrës së kulturës ishte ndërtuar në vitin 1951, ndërsa në vitin 2018 ka filluar rindërtimi i kësaj qendre, ku është ruajtur dhe restauruar salla teatrale e vjetër. Qendra e kulturës gjithnjë ka zhvilluar dhe zhvillon aktivitete të shumta për promovimin e jetës kulturore në Vushtrri. Kjo qendër më së shumti vizitohet nga studentët për shkak të bibliotekës që ndodhet në ndërtesë, si dhe gjatë ngjarjeve për teatër/ kinema.

Kinemaja

Nuk ka ndonjë kinema zyrtare, por gjatë vitit, pjesa e teatrit të Shtëpisë së kulturës përdoret si kinema. Për nder të figurës së shquar të Hasan Prishtinës, Vushtrria-vendlindja e tij që nga viti 2009 organizon manifestimin “Ditët e Hasan Prishtinës” me aktivitete të shumta kulturore.

FESTIVALET DHE NGJARJET


“Takimet e Poeteshave Shqiptare”

- marrin pjesë të gjitha poeteshat përgjatë territorit shqiptar. Ngjarja ka filluar në 1974. Në vitet e para, aktiviteti është mbajtur për nder të 8 Marsit- Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Nxënëset e shkollave të mesme ishin të vetmet që merrnin pjesë, kurse në vitin 1985, numri total i pjesëmarrësve ishte 53. Pas Luftës së Kosovës, aktiviteti ka mbledhur poetesha nga i gjithë territori shqiptar dhe diaspora.



“Ditët e Hasan Prishtinës”


Për nder të figurës së shquar të Hasan Prishtinës, Vushtrria - vendlindja e tij që nga viti 2009 organizon manifestimin “Ditët e Hasan Prishtinës” me aktivitete të shumta kulturore.



Dita e patates

(1–10 tetor)

Vushtrria është e njohur për patatet e saj. Kjo është një ngjarje tradicionale që mbahet çdo vit në Komunën e Vushtrrisë, ku marrin pjesë njerëz nga vende të



ndryshme, intelektualë, biznesmenë, qeveritarë, udhëheqës nga qeveritë e vendeve-ambasadorë të ndryshëm, media dhe njerëz të tjerë relevant.

Panairi i Ditës së mjaltës

I organizuar në bashkëpunim me Shoqatën e bletarëve “EMA”.

Ecja e Pavarësisë

Të rinjtë e Vushtrrisë marshojnë nëpër qytet, qëllimi është për të kujtuar sakrificat e popullit të Kosovës gjatë viteve dhe për të festuar Ditën e Pavarësisë.

Panairi i shkollave

Organizuar nga komuna, OJQ-të dhe vetë shkollat. Ky panair promovon aftësitë dhe arritjet e nxënësve të të gjitha shkollave të Vushtrrisë.

KultFest

Një festival i ri muzikor me grupe lokale dhe të famshme të Kosovës, që organizohet në muajin maj në fshatin Sllakoc të Vushtrrisë.



Panairi Shkencës dhe Kulturës

Ky Panair dy ditë organizohet në nivelin shtetëror dhe fton të rinjtë e të gjitha rajoneve të Shqipërisë. Shkolla të ndryshme paraqesin projekte të ndryshme në fushën e kulturës dhe shkencës.



Çaji

Kjo është një pjesë e rëndësishme e ditës në Vushtrri, kurse sipas traditave mëngjesi gjithmonë fillon me çaj dhe kështu vazhdon gjatë ditës. Çaji i zi ose çaji i rusit siç quhet nga vendorët, duhet shërbyer në gota të vogla, të bëra në veçanti për këtë lloj të çajit. Çaji shërbehet në shumë kafene dhe çajtore (një çaj kushton 0.15 cent).

Këshillë: Tradita është që të pini të paktën tre çaja radhazi.



Kafeja turke

Ky lloj i kafesë është pija e preferuar në qytet. Zakonisht gratë pinë kafënë e tyre në mesditë, por në kafene ajo shërbehet gjatë gjithë ditës. Sipas traditës, ajo shërbehet në gota të vogla të kafesë.

Këshillë: Kafeja turke gjithashtu përdoret për lexim të fatit.

USHQIMI DHE PIJET E VEÇANTA NË VUSHTRRI

Vushtrria është e njohur për ushqimin e saj të shijshëm. Ne ju rekomandojmë që patjetër të provoni disa prej ushqimeve dhe pijeve lokale. Vini re se mishi i derrit nuk shërbehet në Vushtrri, pasi që shumica e popullsisë është e besimit musliman.



Boza

Boza përbëhet nga mielli i misrit, uji dhe sheqeri. Kjo pije shërbehet në pastiqeri të qytetit.

Këshillë: Boza është një nga pijet më të ëmbla që kenë provuar gjithë jetën tuaj.



Shpicer

Shpicer është përzierje e bozës dhe limonadës. Kjo është një pije e veçantë në Vushtrri dhe mund të shërbehet në pastiqeri.

Këshillë: Nëse doni një version më të thartë të bozës kërkoni shpicer.



Sugjuku

Suxhuku përbëhet nga mishi i grirë, qepa dhe piperi i kuq. Ai gatuhet në zgarë të tymosur dhe shërbehet me sallatë dhe specia të pjekur.

Këshillë: Merrni suxhuk djegës. Është shumë i shijshëm.



Qebapët

Qebapët bëhen nga mishi i grirë, qepa dhe piperi. Gatuhet në zgarë të tymosur dhe shërbehen me sallatë dhe specia të pjekur.

Këshillë: Kërkoni qebapë në kajmak.



Llokumi

Llokumi është një lloj petulle tradicionale, një lloj brumi i skuqur. Ai mund të hahet me diçka të ëmbël apo njelmët.

Këshillë: Kërkoni ajvar (pastë e specave) ose kombinuar specia me lëng.



Flija

Flija e njohur gjithashtu si fli, përbëhet nga shtresa të shumëfishta sikurse palpetat, të lyera me krem dhe shërbehet me kajmak.

Këshillë: Pyetni në Qendrën e informacionit turist për demonstrimin se si bëhet flija.

RESTORANTE


Hot Caffe

Hot caffe gjendet në rrugën "Pandeli Sotiri" apo rruga e kafiterive, në këtë kafiteri përgatitet kafeja më e mirë në qytet.




Bistro Sofra

Specialitete të ndryshme ushqimore nga grilli dhe është gjithashtu i njohur për pula. Janë dy dyqane, një në rrugën "Tirana", dhe një në rrugën "Dëshmorët e Kombit". Është i hapur prej orës 06:00 deri në 23:00.



Pasion Pizza

Përgatit pica nga furra dhe ushqim tradicional, ndodhet në rrugën "Pandeli Sotiri", lokali është i hapur nga ora 07:00 deri 00:00.



Mondo

Një vend shumë i bukur për të gjitha moshat, ku ju mund të shërbeheni me kafe, pije dhe ëmbëlsira. Ndodhet në sheshin "Adem Jashari", është i hapur nga ora 07:00 deri 00:00.


Te Biti

Ata janë të njohur për qebapë dhe veçanërisht suxhuk të bërë në shtëpi, ndodhet në të kundërtën e Xhamisë së Madhe. Është i hapur nga ora 05:00 deri në 23:00.



Rinia Sweets

Ndodhet në sheshin "Adem Jashari" dhe është i hapur nga ora 07:00 deri 00:00. Ky është dyqani më i vjetër i ëmbëlsirave në qytet.



Te Nexhati

Një qebaptore shumë e frekuentuar me qebapë të shijshëm dhe suxhuk të tymosur. Ndodhet pranë parkut të qytetit dhe është i hapur nga 06:00 deri në 23:00.

KU TË QËNDRONI

Hotel "Kalaja"

Ndodhet në rrugën "2 Maji", rruga magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, kilometri i 22-të nga Prishtina dhe kilometri i 10-të nga Mitrovica. Gastronomi dhe akomodim hoteli, ka një dhomë mbreti, 6 dhoma-apartamente, 9 dhoma dyshe dhe 27 dhoma teke.

Çmimi: fillon nga 20 euro për një natë.

www.hotel-kalaja.com

Parking + Wi-fi



Hotel "Amazon" (hotel me 4 yje)


Ndodhet në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, 8 km larg nga Vushtrria, hoteli ka 30 dhoma për akomodim, restorant, konferencë dhe salla.

Çmimi: fillon nga 25 euro për një natë.

<http://www.hotelamazona.com/>

Parking + Wi-fi





Kalaja e Vjetër

Historia e Vushtrrisë është shënuar nga një shumëllojshmëri e sundimtarëve dhe ndikimeve kulturore. Pavarësisht influencës që ka pasur qyteti, kalaja ka duruar dhe ka mbetur deri tani. Prandaj, kalaja ka një vlerë të madhe historike, si një simbol për qytetin dhe historinë e saj të gjatë. Lokaliteti arkeologjik “Kalaja e Vushtrrisë” ndodhet në qendër të qytetit dhe përbëhet nga struktura të ndërtimit me shtresa të periudhave të ndryshme historike. Disa historianë sugjerojnë se kalaja është ndërtuar në shekullin e 7-të gjatë epokës bizantine. Është sugjeruar gjithashtu se kalaja rrjedh nga periudha iliro-dardane.

Për shkak të pozitës të saj strategjike, në kohën që u ndërtua dhe gjatë pushtimit osman, kalaja është përdorur për nevoja ushtarake. Thuhet se gjatë pushtimit otoman kalaja u përdorur si një burg dhe gjykatë turke. Pas kësaj, ajo ka shërbyer si një depo armësh, ndërsa kulla ka shërbyer si hambar dhe depo misri. Në shekullin e 20-të, kalaja u përdorur si burg, vend për mbajtjen e deleve, fushë për voleyboll, etj. Gjatë 1955-1958 kalaja u përdorur si një kinema, restorant dhe një vend për vallëzim ballo ishte vënë në oborrin e brendshëm. Kalaja u përdorur nga qytetarët deri në vitin 1962. Sot pas restaurimit të monumentit të kalasë nga CHwB-ja, pëveç se mund të vizitohet si një lokalitet i trashëgimisë kulturore, në ambientin e kalasë zhvillohen edhe aktivitete të shumta kulturore, hapen ekspozita të ndryshme, mbahen trajnime, etj.

ÇFARË TË SHIHNI





Hamami i Vushtrrisë

(banjë publike)

Hamami është ndërtuar në pjesën veriperëndimore të qytetit të vjetër. Kjo banjë publike është ndërtuar në shekullin e XV-të nga Gazi Ali Beu. Është një nga hamamet më të vjetra në Ballkan dhe është përdorur deri vonë pas Luftës së Dytë Botërore. Ai ka shërbyer si një banjë publike për burra dhe gra, që e kanë përdorur hamamin në ditë të ndryshme.

Ura e Vjetër e Gurit

Ky monument është ndërtuar në mes të antikitetit të vonë dhe në periudhat e hershme të mesjetës. Ura ndodhet në pjesën veriperëndimore të qytetit të vjetër. Ajo është 160 metra e gjatë, gjashtë metra e gjërë dhe ka 11 harçe. Megjithatë, bazuar në legjenda ajo kishte 12 harçe, të cilat janë mbuluar më vonë. Ura e Gurit është ndërtuar mbi lumin "Sitnica", por lumi ka ndryshuar rrjedhën e tij disa qindra metra në perëndim.




Muzeu Historik Etnografik Vushtrri

Muzeu i Vushtrrisë u themelua më 9.6.2005 me vendim të Kuvendit Komunal. Për 13 vite, fushëveprimtarinë e zhvilloi në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina", ndërsa për një vit në "SHMU II", derisa u vendos në shtëpinë e përhershme në monumentin "Shtëpia e Mahmut agë Gjinollit me vendim të ansamblesë komunale që nga viti 2017. Në këtë periudhë të shkurtër, nga themelimi e deri më sot, në menaxhim të personelit profesional është arrit të grumbullohet një thesar i çmuar i artefakteve të kulturës materiale dhe shpirtërore nga kjo trevë, duke përfshirë: ekponate arkeologjike, historike, etnologjike, folklorike, nga teknologjia e vjetër, etj.

Muzeu Memorial - Kulla e Azem dhe Shote Galicës

Vendi ku heronjtë Azem dhe Shote Galica kanë jetuar. Kulla e vjetër e Azem Galicës është ndërtuar në shekullin e njëzetë. Monumenti është ndërtuar në fshatin Galicë, në një kodër ku dominon sipërfaqja përreth. Ky fshat është përmendur për herë të parë në vitin 1455 në fletoren e Vilajetit Otoman Vëllk.



Shtëpia e Shaban Agës

Shtëpia i përket fundit të shekullit 19-të ose fillimit të shekullit të 20-të. Ajo u ndërtua nga pronari, Shaban Haxhi Aga, një tregtar i pasur i asaj kohe. Shtëpia është përdorur gjithmonë për qëllime banimi, sikurse dhe vazhdon të përdoret. Shtëpia është përdorur nga familja e pronarit, anëtarët e të cilit janë të njohur si pionierë të arsimit. Shtëpia P+1, e ndërtuar me gur, qerpiç dhe dru, përfaqëson stilin tradicional të arkitekturës të shtëpive qytetare të Kosovës, me vestibul të mbyllur. Shtëpia është e mbuluar nga një çati me kulm të pjerrët shumëujor, me tegola. Kati i parë është i ndërtuar në mure guri, i destinuar për përdorim komercial dhe magazinim, ndërsa kati i sipërm është ndërtuar në "stilin Bondruk", i dalë nga mbështjellësi. Si në eksterier ashtu dhe në enterier, shtëpia është e shquar për elementet e saj funksionale dhe dekorative në dru. Shtëpia gjithashtu ka ruajtur përgjithësisht strukturën e saj origjinale.



Xhamia e Gazi Ali Beut

Xhamia e Gazi Ali Beut ndodhet në qendër të qytetit të vjetër të Vushtrrisë, përafërsisht 100 metra larg nga Hamami. Xhamia është ndërtuar në mes të shekullit të 15-të. Që nga fillimi deri më sot xhamia shërbeu si një ndërtesë e shenjtë për ritet fetare, ceremonitë e bashkësisë islame. Xhamia përbëhej nga një sallë e lutjes, mobile fiksë dhe minarja. Deri në vitin 1999, përveç disa ndërhyrjeve të vogla, xhamia ka ruajtur karakteristikat origjinale arkitektonike. Pas shembjes së saj në vitin 1999, ajo u rindërtua pas disa muajsh duke humbur të gjitha karakteristikat e saj origjinale arkitektonike, pa ruajtur pjesët origjinale as në hapësirë dhe as në strukturë.

Kisha e Shën Lazarit - Samadrexhë

Kisha e Samadrexhës ndodhet në fshatin Samdrexhë, 6 km në lindje të qytetit të Vushtrrisë. Sipas anekdotave të popullatës, kisha u ndërtua në shekullin e 14-të nga vendasit e këtij vendbanimi, dedikuar Shën Gjonit. Nga ndërtimi i saj deri në vitin 1999 kisha i ka shërbyer qëllimeve të ndërtesës së shenjtë për komunitetin ortodoks. Në vitin 1932, një kishë e re është ndërtuar mbi themelet e kishës më të hershme, identike me atë të shekullit të 14-të. Kisha me bazë drejtkëndëshe është ndërtuar nga gurë të latuar, me nefe të spikatur në lindje dhe hyrjen në perëndim, Rozeta me kryq është e vendosur mbi hyrje.



Teqeja e qytetit

Në Vushtrri ky objekt kulti i ashtuquajtur "Teqe", ndodhet në parkun e qytetit, në afërsi të shkollës së mesme. Arkitektura e saj është në formë të tetëkëndëshit, brenda të cilit gjenden gjashtë varre, të cilat konsiderohen të jenë varret e shehëve, por gjithashtu mendohet se këto varre janë të njerëzve të rangut të lartë ushtarak në kohën e Perandorisë Osmane. Megjithatë, ky është një objekt fetar. Për teqenë është krijuar një kult, ku ndezën qirinj dhe hidhen monedha brenda. Ka njerëz që shkojnë për të kërkuar fatin, ndezin qirinj në netë të mëdha.



Shtëpia e Mahmut Pashë Gjinollit

Shtëpia e Mahmut Pashë Gjinollit ndodhet në zonën perëndimore të qytetit të Vushtrrisë, pranë lumit "Tërstena". Sipas burimeve historike dhe banorëve lokalë, shtëpia besohet të ketë qenë e ndërtuar në fund të shekullit të 19-të, ose në fillim të shekullit të 20-të, për qëllime banimi. Shtëpia ishte ndërtuar fillimisht për qëllime banimi, por pas Luftës së Dytë Botërore, ajo është përdorur si një ndërtesë administrative dhe më vonë (rreth 1960 - 1970) ajo është përdorur si një pikë e shëndetit, ndërsa pas përmbytjeve në vitin 1978, shtëpia ishte përdorur si strehë për familjet që kanë vuajtur nga përmbytjet. Shtëpia ka strukturë B+P+1, e ndërtuar me gurë natyror dhe pjesërisht me tulla të plota, ndërsa konstruksioni i kulmit është ndërtuar nga druri i lisit.

Me vendim të asamblesë komunale që nga viti 2017 monumenti në fjalë është shndërruar në muze të qytetit.

Shtëpia e Zejnullah Beut

Shtëpi banimi e Zejnullah Beut ndodhet në fshatin Kjo shtëpi banimi e Zejnullah Beut ndodhet në fshatin Balincë të Vushtrrisë. Kjo ndërtesë është e mbrojtur si një monument i trashëgimisë arkitekturale sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore. Ajo është ndërtuar në fillim të shekullit të 20-të, duke qenë një nga shumë prona që ky tregtar i pasur ka në pronësi. Besohet se kjo shtëpi ishte ndërtuar fillimisht si një kasolle vilë-pushimi, pasi familja jetonte në shtëpitë dhe pronat tjera që ata kanë në pronësi në rajonin e Vushtrrisë. Si një patriot i madh dhe pasionant i arsimit, Zejnullah Beu e dha këtë shtëpi që të përdoret si shkollë. Të dhënat na tregojnë se para dhe gjatë luftës në Kosovë, kjo shtëpi ka funksionuar si një stacion policor, me dhomat e burgut të vendosura në katin e sipërm.



Kulla e Kadri Hysenit

Oshlani përmendet për herë të parë si një vendbanim në shekullin e 15-të. Sipas burimeve, ai është përmendur së pari në Deferin Mufassal të Vilajetit Vlk, në vitin 869 (Gazeta e Kadastrit dhe Regjistrimit në 1455). Fshati ishte i njohur për kullat e tij, por sundimtarët serbë dogjën shumicën. Kulla e Kadri Hysenit është ndërtuar në shekullin e 19-të nga gurët e gdhendur, me një oborr të gjerë të rrethuar me mure nga guri. Kjo kullë ka dy kate, ku përveç dritareve drejtkëndëshe, hapje të bëra më vonë, ajo karakterizohet me frëngji të hapura në të katër anët, e cila dëshmon se kulla është ndriçuar fillimisht vetëm me hapje të tilla, duke e ditur rolin dhe funksionin e saj në atë kohë. Kulmi është i mbuluar nga tegolat. Përveç kullës dhe ndërtesave të saj ndihmëse, karakteristike janë edhe portat e hyrjes të mbuluara me çati, muret e oborrit nga guri, dhe rrethoja e pusit, gjithashtu e ndërtuar nga gurët masiv.



Kullat në fshatin Gumnishtë

Disa nga kullat në këtë fshat janë ndërtuar nga mjeshtër dibranë e maqedonas, por gjithashtu ka tjera që janë ndërtuar nga vendasit. Gati shumica e kullave janë ndërtuar nga gurë të gdhendur që janë marrë nga muret e lokalitetit antik në Gumnishtë dhe janë punuar nga vendasit. Në muret e këtyre kullave vërehet stili me motive diellore gjeometrike, që lidhet me diellin dhe hënën, që është e gdhendur shumë shpesh në oxhaqe, mbi dyer, dritare. Pothuajse të gjitha oborret e pasme janë puse rrethore me dekor dhe shkronja të skalitura të punuara nga zotërinjtë e fshatit, duke përdorur gurë lokal. Ndërtimet dalluese të gurit në fshat janë 10 kullat, rrënojat e mbetura nga lufta e fundit të djegura nga ushtria e Serbisë.



Shtëpia e Kulturës “Hasan Prishtina”

Shtëpia e Kulturës në Vushtrri u ndërtua në vitin 1951. Në këtë shtëpi janë mbajtur aktivitete të mëdha kulturore dhe artistike. Aktualisht këtu janë të vendosura Biblioteka e qytetit “Naim Frashëri”, arkivi i qytetit, Ansambli “Hasan Prishtina”, teatri i qytetit, departamenti i rinisë dhe disa qendra rinore. Pas çlirimit të shtëpisë së kulturës, emri i patriotit, Hasan Prishtina iu kthye dhe ajo është bërë qendra e aktiviteteve kulturore.

Aktualisht nga objekti i vjetër është ruajtur vetëm salla teatrale.



UDHËTIME DITORE

Udhëtime ditore

nga guida të certifikuara lokale të Vushtrrisë

Shukrane Begu +383 44 361172
Egzona Azemi +383 45 571428
Shaban Latifi +383 45 333393
Avdi Mehmeti +383 44 43729

Turne njëditor:

Bashkohuni me ne në qytetin e vjetër të Vushtrrisë dhe rrethinën e saj

Kjo paketë turne përfshin elementet që ju japin mundësinë për të vizituar trashëgiminë e ngrohtë tradicionale të Vushtrrisë dhe rrethinat e saj, si në Prishtinë, Gazimestan, Mazgit / Obiliq. Me një turne të organizuar ju mund të vizitoni disa nga vendet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve të atyre vendeve dhe Vushtrrisë së lashtë.

Turne njëditor:

Bashkohu me një qytet historik dhe me urën e tij pa lumë

Kjo është një paketë e organizuar për të kaluar një ditë në Vushtri, duke vizituar Kalanë e Vjetër të Qytetit, Urën e Vjetër të Gurit, Hamamin, Muzeun e Vushtrrisë, shtëpitë e vjetra dhe duke shëtitur nëpër rrugët e qytetit do të vizitohet edhe atraksione të tjera.

Ejani dhe merrni një kujtim nga një qytet i lashtë me urën pa lumë, kishën pa priftërinj dhe kazermë pa ushtarë!



SHKONI PERRETH

Pasi që Vushtrria është një qytet i vogël nuk ka nevojë për transport publik, për shkak se çdo pjesë e qytetit mund të arrihet me këmbë.

Nëse dëshironi të shkoni në fshatrat përreth, ka autobusë të vegjël që ndodhen në afërsi të Urës së Gurit.

(të gjithë autobusët janë të rregullt, nga e hëna deri të prëmtën)

Vushtrri	Balincë
7.00	7.20
9.00	9.30
11.30	12.00
13.00	13.20
15.00	15.20
16.00	16.35
18.00	18.25
19.00	19.3

Vushtrri	Oshlan
9.00	10.00
11.15	12.00
13.00	13.45
15.15	15.50
17.00	17.50
19.00	19.30

Vushtrri	Pasom
7.00	7.30
9.00	9.30
11.10	11.35
13.00	13.45
15.15	16.10
17.10	17.40
18.30	19.10

Vushtrri / Skrome / Gumnishtë / Karaqe	
9.30	10. 10
10.50	11.25
12 .15	13.10
16.40	17.10
18.30	19.15.

Vushtrri	Galicë
5:25	6:10
7:20	7:50
11:15	11:55
13:00	13:25
16:00	16:25
19:00	19:25

TREGU (PAZARI)

Interex



Interex ka më shumë se tre dyqane në Vushtrri, duke filluar nga ai që është përgjatë autostradës Prishtinë-Mitrovicë. Në këtë kompleks të tregut ju mund të gjeni ushqime, piqe, rroba, furnizime kuzhine, dekorime të brendshme etj. Emona Fruits and Vegetables ndodhet në rrugën “Mic Sokoli”. Është e hapur çdo ditë përveç festave, nga ora 07:00 deri në 23:00.

Viva Fresh Store



Shtëpia e mallrave gjendet në rrugën “Mic Sokoli”. Ajo është e njohur si “Shtëpia e Mallrave” dhe ka 4 kate, një për ushqim, dhe të tjerat për

pajisje pune, pajisje kuzhine, libra dhe veshmbatje. Ajo është e hapur nga ora 07:00 deri në 23:00, përveç ditëve të festave.

Bookstore “Migros”



Ky dyqan është në sheshin “Adem Jashari” dhe është i hapur prej orës 08:30 deri në ora 21:00. Ai është vendi më i mirë ku ju mund të blini një palë këpucë, atlete, priza, çizme, rroba, veshje të bukura sportive dhe më shumë. Është distributor zyrtar i Nike dhe Adidas.

Store “Dini” (addidas, rebook)



Ky dyqan është në sheshin “Adem Jashari” dhe është i hapur prej orës

08:30 deri në ora 21:00. Ai është vendi më i mirë ku ju mund të blini një palë këpucë, atlete, priza, çizme, rroba, veshje të bukura sportive dhe më shumë. Është distributor zyrtar i Nike dhe Adidas.

USTOP



Ky dyqan me rroba italiane ndodhet në sheshin “Adem Jashari”, është i hapur nga ora 10:00 deri në orën 20:00 me përjashtim të të dielave, kur ai është e mbyllur.

Revolution



Në këtë dyqan ju gjeni rroba, këpucë dhe veshje sportive. Ndodhet në sheshin “Adem Jashari”, është i hapur nga ora 09:00 deri në 22:00, me përjashtim të të dielave, kur është i mbyllur. Është distributor zyrtar i Nike-s.

Forma



Dyqan i aksesorëve, ku ju mund të gjeni ora, unaza, byzlykë dhe shalla etj. Dyqani ndodhet në sheshin “Adem Jashari”. Është i hapur nga ora 09:00 deri në 22:00, me përjashtim të të dielave, kur është i mbyllur.

Dyqani i telefonave mobil Gold



Merrni markën tuaj të re Samsung apo Iphone në dyqanin e telefonave

Gold. Ai gjithashtu ofron shërbime të teknologjisë së lartë, duke përfshirë riparimin e telefonave. Ndodhet në sheshin “Adem Jashari” dhe është i hapur nga ora 09:00 deri në ora 22:00.

NesPHOTO



Fotograf për 70 vjet, pronari i NesPHOTO do t’ju bën një fotografi që kurrë nuk do ta harroni. Ai gjithashtu ka imazhe biometrike, gjendet në sheshin “Hasan Prishtina”. Është i hapur prej orës 08:00 deri në orën 20:00, me përjashtim të të dielave kur ai është i mbyllur.

Casio



Orëndreqës për orë të vjetra dhe të reja. Ndodhet në sheshin “Hasan Prishtina” dhe është i hapur prej orës 08:00 deri në 20:00.

Bizhuteri Margarita



Ky dyqan ndodhet në rrugën “Hasan Prishtina”, është i hapur nga ora 09:00 deri 18:00, me përjashtim të të dielave. Mund të shërbehemi me aksesorë argjendi, (Esplin Tiso etj) syze dhe aksesorë tjerë.

Herbal



Dyqan me produkte të barishteve, ndodhet në rrugën “Tirana”, përballë kalasë.

Artizanat “Te Duda”

Artizanale të ndryshme dhe pajisje tradicionale, ndodhet në tregun e qytetit të njohur si “pazari” në rrugën “Hamit Hyseni”. Numri i dyqanit është: C15 - C16. Ai është i hapur nga ora 08:00 deri 19:00. Ka edhe dyqane të tjera në pazar që merren me zejtarë dhe aksesorë, kurse pronarët e tyre janë kryesisht gra nga Vushtrria dhe njëra nga to është edhe Elheme Hasani, e cila përveç që punon me artizanale, gjithashtu prodhon një krem natyral për fytyrë nga përbërësi kryesor, insekti i quajtur “zhiva” dhe kremi njihet si “të bardhët e zhivës”.

Pazari

Ka dyqane të ndryshme afariste, në rrugën “Hamit Hyseni” përballë Urës së Gurit, është i hapur nga ora 08:00 deri 19:00. Është një zakon në Vushtrri që ky vend të vizitohet të premteve, kështu ka mbetur nga e kaluara, kur njerëzit nga fshati vinin në shtëpi të furnizuar me gjëra, por ky zakon ishte po ashtu për njerëzit që jetonin në qytet.



Implementuar dhe financuar nga:



Pjesë e programit:



PLANET LOCALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE 2012-2015
LOKALNI PLANOVI KULTURNI BASTINE 2012-2015
LOCAL CULTURAL HERITAGE PLANS 2012-2015